

Republika e Kosovës
 Republika Kosova-Republic of Kosovo
 Qeveria - Vlada - Government
 Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
 Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
 Ministry of Local Government Administration

Për :	Ardian Gjini, Kryetar i Komunës së Gjakovë Anton Shala, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Gjakovës	
Kopje	Njësia për Administrimin e Dokumenteve në MAPL Njësia për Administrimin e Dokumenteve në Komunë	
Përmes:	Ivan Todosijević, Ministër i MAPL-së Rozafa Ukimeraj, Sekretare e Përgjithshme e MAPL-së	
Nga:	Venera Çerkini, Drejtor i Departamentit Ligjor dhe Monitorim të Komunave MAPL	Datë: 21/01/2019 Nr. 020/33
Lënda:	Kërkesë për rishqyrtim të ligjshmërisë së aktit të komunës së Gjakovës	
Lloji i aktit:	Vendim i Kuvendit të Komunës	

I nderuar Kryetar,
 I nderuar Kryesues,

Në pajtim me Rregulloren e QRK-së Nr. 01/2016 për Shqyrtimin administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren e Qeverisë Nr. 02/2011 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Departamenti Ligjor dhe Monitorim të Komunave i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr.03/L-040 Për Vetëqeverisje Lokale aktin komunal në vijim:

Vendim nr. 01-463/02-33027/18 për zgjatjen e afatit lidhur me dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së komunës kompanisë "Cacoo" SH.P.K në hapësirat e Pallatit të Kulturës
I miratuar më datë: 04.12.2018
I parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë: 14.01.2019

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës si më sipër, vlerëson se akti i komunës **është në kundërshtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi.**

Mos pajtueshmëritë e aktit të komunës të parashtruar për shqyrtim të ligjshmërisë janë si në vijim:

Nr.	Formulimi në aktin e komunës	Dispozita ligjore me të cilën akti i komunës është në kundërshtim.
1.	Vendim nr. 01-463/02-33027/18 për zgjatjen e afatit lidhur me dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së komunës kompanisë "Cacao" SH.P.K në hapësirat e Pallatit të Kulturës	<p>Vendim nr. 01-463/02-33027/18 për zgjatjen e afatit të shfrytëzimit të pronës së paluajtshme të komunës nga dhjetë (10) në pesëmbëdhjetë (15) vite kompanisë "Cacao" SH.P.K në hapësirat e Pallatit të Kulturës të Komunës së Gjakovës është në kundërshtim me Ligjin nr. 04/l-144 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e pronës së Paluajtshme të Komunës. Ligji nr. 04/l-144 përcakton 2 (dy) procedura të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të komunës përmes <u>ankandit publik</u> për periudha nga një (1) deri në pesëmbëdhjetë (15) vite; • Dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës përmes <u>konkurrimit të hapur</u> për periudhën nga pesëmbëdhjetë (15) deri nëntëdhjetë e nëntë (99) vite; <p>Andaj <u>zgjatja e afatit nga dhjetë (10) në pesëmbëdhjetë (15) vite</u> është në kundërshtim me nenin 5 dhe 6 të Ligjit nr. 04/l-144 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës dhe procedurat e lartcekura.</p>

Bazuar në të cekurat më lartë, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal kërkon nga Kuvendi i Komunës/Kryetari i Komunës që të ndërmarrin veprime konkrete që aktin e komunës ta harmonizojnë me dispozitat ligjore në fuqi, brenda 30 ditësh nga data e pranimit të kërkesës për rishqyrtim të aktit.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, mbetet në dispozicion të komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm në lidhje me këtë vlerësim.



Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal

Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave

Ministry of Local Government Administration



Za :	Ardian Gjini, gradonačelnik Opštine Đakovica Anton Shala, predsedavajući Skupštine opštine Đakovica	
Kopija:	Jedinici za administraciju dokumenata u MALS-u Jedinici za administraciju dokumenata u opštini Zakonsko odeljenje i monitorisanje opština MALS	
Preko: ZA	Ivan Todosijević, ministar MALS-a Rozafa Ukimeraj, generalna sekretarka MALS-a	
Od:	Venera Çerkini v.d. rukovodioca Pravnog odeljenja i monitorisanje opština/ MALS	Datum, 21.01.2019.
Predmet:	Zahtev za reviziju zakonitosti akta opštine Đakovica	Br.020-33
Vrsta akta:	<input type="checkbox"/> Odluka Skupštine opštine	

Poštovani gradonačelnice,
Poštovani predsedavajući,

U skladu sa Uredbom Vlade Republike Kosova br.01/2016 za administrativno razmatranje opštinskih akata, i na osnovu zakonskih nadležnosti ministarstva, određenim osnovnim zakonima i Vladinom Uredbom br.02/2011 o poljima administrativne odgovornosti Kancelarije premijera i ministarstva, Odeljenje za pravna pitanja i monitorisanje opština Ministarstva administracije lokalne samouprave primilo je za obavezno razmatranje zakonitosti akta opštine, onako kako je predviđeno članom 81. Zakona br.03/L-040 o lokalnoj samoupravi kao u nastavku:

Odluka br. 01-463/02-33027/18 o produženju roka u vezi sa davanjem na kratkoročno korišćenje imovine opštine kompaniji "Cacao" SH.P.K u prostorijama Doma kulture
Usvojena dana, 01.12.2018. godine,
Predložena za razmatranje u MALS-u, dana, 14.01.2019. godine,

Ministarstvo administracije lokalne samouprave, nakon razmatranja sadržaja gore navedenog opštinskog akta, ceni da je opštinski akt u suprotnosti sa odredbama zakonodavstva na snazi.

U nastavku možete naći neslaganja opštinskog akta koji je dostavljen za razmatranje zakonitosti:

Br.	Formuliranje u opštinskom aktu	Zakonska odredba sa kojom je opštinski akt u suprotnosti.
1.	Odluka br. 01-463/02-33027/18 o produženju roka u vezi sa davanjem na kratkoročno korišćenje imovine opštine kompaniji "Cacao" SH.P.K u prostorijama Doma kulture	<p>Odluka br.01-463/02-33027/18 o produženju roka korišćenja nepokretne opštinske imovine od deset (10) na petnaest (15) godina za preduzeće "Cacao" D.O.O. u prostorijama Doma kulture u Đakovici u suprotnosti je sa Zakonom br.04/l-144 o davanju na korišćenje i razmenu nepokretne imovine opštine. Zakon br. 04/l-144 određuje dve (2) procedure davanja na korišćenje nepokretne imovine opštine:</p> <ul style="list-style-type: none"> • davanje na kratkoročno korišćenje nepokretne opštinske imovine putem <u>javne licitacije</u> za period od (1) do petnaest (15) godina; • davanje na dugoročno korišćenje nepokretne opštinske imovine putem <u>otvorenog konkursa</u> za period od petnaest (15) do devetdeset i devet (99) godina; <p>Stoga, <u>produženje roka od deset (10) na petnaest (15) godina</u> je u suprotnosti sa članom 5. i 6. Zakona br.04/l-144 o davanju na korišćenje i razmenu nepokretne imovine opštine i gore navedenim postupcima.</p>

Na osnovu gore navedenog, Ministarstvo administracije lokalne samouprave *traži* od Skupštine opštine i gradonačelnika opštine Đakovica da preduzmu konkretne mere kako bi se opštinski akt uskladio sa zakonskim odredbama na snazi, u roku od 30 dana od dana prijema zahteva za reviziju akta.

Ministarstvo administracije lokalne samouprave ostaje na raspolaganju opštine za bilo kakvo objašnjenje u vezi sa ovom procenom.



REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVO REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJAKOVËS

OPŠTINA DJAKOVICA MUNICIPALITY OF GJAKOVA

HYRËSE-ULAZNA-INCOMING
 REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIC OF KOSOVO
 OPŠTINA E KOSOVËS Vlada KOSOVO GOVERNMENT OF KOSOVO

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
 Ministarstvo Lokalne Samosprave i Administracije
 Ministry of Local Government Administration

Data: 19.01.2019
 Datum: 19.01.2019
 Date:

Numri organizatorik	Nr. Lendës	Gjujca	Vlera
-01-	020-	33	

Kuvendi i Komunës - Gjakovë
 01.nr. 463/2-330-2018
 Dt. 04.12.2018

Kuvendi i Komunës së Gjakovës, duke u bazuar në nenin 12 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr 03 L-040, nenin 5 dhe nenin 9 të Ligjit nr. 04 L-144 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtshme Komonale, nenin 4 dhe 5 të Rregullores së QKR-së nr. 23/2013 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtshme Komonale, në mbledhjen e mbajtur me datë 04.12.2018, pas diskutimit hapësirë me pikën e 3-të, të rendit të ditës: Propozimi për zgjatjen e afatit të shfrytëzimit të hapësirave të Pallatit të Kulturës nga Kompania "Cacao" SH.P.K. nga 10 në 15 vite, e miratohet kështu:

V E N D I M

Për zgjatjen e afatit të shfrytëzimit të pronës komonale

1. Aprovohet rekomandimi i Komisionit për Dhënien në Shfrytëzim të Pronës Komonale për zgjatjen e afatit të shfrytëzimit të pronës komonale Kompanisë "Cacao" SH.P.K. në hapësirat e Pallatit të Kulturës.
2. I zgjatët afati i shfrytëzimit të pronës Komonale nga 10 në 15 vite, Kompanisë "Cacao" SH.P.K. me adresë në rrugën "Nëna Tereze" pë nr. në Gjakovë i përcaktuar në kontratën me numër të protokollit 01-463/01-21147 e datës 04/10/2017 për Shfrytëzimin e pronës komonale.
3. Ky vendim lyp në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb faqen e komunës.
4. Vendimi iu dërgohet:
 - Kryetarit të Komunës, z. Ardit Gjini
 - Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal
 - Drejtorisë për Kadastër Gjeodezi dhe Pronë
 - Shërbimit Profesional të Kuvendit të Komunës
 - Arkivit



Kuvendi i Komunës
 Anton Shala



REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVO/ REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E GJAKOVËS

OPŠTINA DJAKOVICA/ MUNICIPALITY OF GJAKOVA

Kuvendi i Komunës – Gjakovë

01, nr. 463/02-33024/2018

Dt. 04.12.2018

Kuvendi i Komunës së Gjakovës, duke u bazuar në nenit 12 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr.03/L-040, nenin 5 dhe nenin 9 të Ligjit nr. 04/L-144 për Dhënie në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtshme Komunale, nenit 4 dhe 5 të Rregullores së QKR-së nr. 23/2013 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtshme Komunale, në mbledhjen e mbajtur me datë 04.12.2018, pas diskutimit lidhur me pikën e 3-të, të rendit të ditës: Propozimi për zgjatjen e afatit të Shfrytëzimit të hapësirave të Pallatit të Kulturës nga Kompania “Cacao” SH.P.K. nga 10 në 15 vite, e miratoi këtë:

V E N D I M

Për zgjatjen e afatit të shfrytëzimit të pronës komunale

1. Aprovohet rekomandimi i Komisionit për Dhënie në Shfrytëzim të Pronës Komunale për zgjatjen e afatit të shfrytëzimit të pronës komunale Kompanisë “Cacao” SH.P.K. në hapësirat e Pallatit të Kulturës .
2. I zgjatët afati i shfrytëzimit të pronës Komunale nga 10 në 15 vite, Kompanisë “ Cacao” SH.P.K me adresë në rrugën “Nëna Terezë” pa nr. në Gjakovë i përcaktuar në kontratën me numër të protokollit 01-463/01-21147 e datës 04.10.2017 për Shfrytëzimin e pronës komunale .
3. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb faqen e komunës.
4. **Vendimi iu dërgohet:**
 - Kryetarit të Komunës, z. Ardian Gjini .
 - Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal.
 - Drejtorisë për Kadastër Gjeodezi dhe Pronë .
 - Shërbimit Profesional të Kuvendit të Komunës .
 - Arkivit.



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Anton Shala

E K S T R A K T
NGA PROQESVERBALI

Komisioni i formuar ne bazë të Vendimit 01nr.112/02-3955/2018, në takimin e mbajtur me dt.14.11.2018, në fillim në ora 10,në sallën nr.8, të Kuvendit të Komunës së Gjakovës, për shqyrtimin e kërkesës të Kompanisë “Cacao” SH.P.K.me adresë në Rr. “Nëna Terezë” p.n. Gjakovë me përfaqësues Adnan Krasniqi, për zgjatjen e afatit të Kontratës të dt.04.10.2017 me numër të protokollit 01-463/01-21147, si dhe uljen e qeras me 50% të shumës nga vlera 1100.00€, mori këtë:

V E N D I M

1. Kompanisë “Cacao” SH.P.K.me adresë në Rr. “Nëna Terezë” p.n. Gjakovë, me përfaqësues Adnan Krasniqi nga Gjakova i zgjatet afati i kontratës të dt.04.10.2017, me numër të protokollit 01-463-/01-21147, për dhënien e paluajtshmëris në shfrytëzim, të përshkruar si në këtë kontratë nga 10 vite në 15 vite në periudhën afatshkurtër.
2. Kërkesa për uljen e çmimit nga shuma prej 1100.00€, në vlerën e gjysmës së saj për pagesën e qerasë, të njëjtit i refuzohet dhe shuma për qiranë mbetet e njëjtë në vlerën e përcaktuar me këtë kontratë, dhe i njëjti është i obliguar ti përmbahet asaj.

Vendosur me dt.14.10.2018, me nr.01-353/01-30359

PROQESVERBAL

I KOMISIONIT PËR DHËNJEN E TOKËS NË SHFRYTËZIM TË PRONËS KOMUNALE

Komisioni i formuar ne bazë të Vendimit 01nr.112/02-3955/2018, në takimin e mbajtur me dt.14.11.2018, në fillim në ora 10,në sallën nr.8, të Kuvendit të Komunës së Gjakovës, për shqyrtimin e kërkesës të Kompanisë "Cacoo" SH.P.K.me adresë në Rr. "Nëna Terezë" p.n. Gjakovë me përfaqësues Adnan Krasniqi, për zgjatjen e afatit të Kontratës të dt.04.10.2017 me numër të protokollit 01-463/01-21147, si dhe uljen e qeras me 50% të shumës nga vlera 1100.00€.

RENDI I DITËS

1. Zgjatja e afatit të Kontratës së lartë shënuar nga 10 vite që është përcaktuar për dhënie e paluajtshmëris në shfrytëzim, në 15 vite në periudhë afatshkurtër dhe zbritja e shumës nga vlera 1100.00€, në shumën prej 50% të saj.

U konstatua se prezent janë këta anëtar të komisionit

1.Znj.Afërdita Lama

2.Z.Flamur Fetahaj

3.Znj.Drita Buza

4.Z.Zef Komoni

5.Z.Mimoza Shala

Në takim të këtij Komisioni munguan Idriz Daci dhe Shpat Nivokazi (me arsye).

Takimin e hapi kryesuesi i Komisionit znj Afërdita Lama. E njëjta i njoftojë me kërkesën dhe përmbajtjen e saj e ushtruar nga "Cacao" SH.P.K.me adresë në Rr."Nëna Terezë" p.n. Gjakovë me përfaqësues Adnan Krasniqi , e cila ka të bëjë me zgjatjen e afatit të kontratës të dt.04.10.2017, me numër të protokollit 01-463/01-21147, për dhënien në shfrytëzim të objektit të kinemasë së qytetit siç është përcaktuar me kontratë dhe zbritjen e shumës. Në diskutim fillimisht pasi që u njoftua me përmbajtjen e kërkesës, u inkuadrua anëtarja e komisionit Znj.Drita Buza e cila theksojë se nuk e përfillë respektivisht nuk pajtohet me kërkesën e tillë, pasi që është fillimi i realizimit të kësaj kontrate, dhe me sa duket ende është një vit, dhe të shohim se si shkon ecuria e realizimit të saj.

Anëtarja e Komisionit Mimoza Shala theksojë se ka qenë mirë që të e dimë se si ka shkuar ecuria e dhënies në shfrytëzim, për paluajtshmërin e cila është objekt i diskutimit.

Anëtari i komisionit Flamur Fetahaj theksojë se dokumentacioni respektivisht kontrata e lidhur për këtë çështje kanë qenë të kryera në periudhën e qeverisjes së kaluar. Kryesuesi i Komisionit Afërdita Lama theksojë se në këtë objekt që është lidhur kontrata për dhënien në shfrytëzim investimet janë të dukshme.


Flamur Fetahaj theksojë se është i pajtimit që të vazhdohet qiramarrësit afati për dhënien në shfrytëzim nga 10 vite sa e kishte në kontratë, në 15 vite. Zef Komani ishte i pajtimit që të i zgjatet afati ashtu siç u theksua nga parafolësi por çmimi për qiranë nuk duhet të ulet domethënë nuk mund të zbritet 50% e shumës së theksuar në kontratë por i njëjti të mbetet ashtu siç është përcaktuar me parë në kontratën e theksuar si më lartë.

Pas këtyre diskutimeve unanimisht u pajtuan të gjithë anëtarët prezent që të njëjtit të i zgjatet kontrata nga afati në 10 vite, deri 15 vite kurse shuma e pagesës e përcaktuar si në kontratë të mos zbritet por ajo të mbetet e njëjtë siç është përcaktuar më parë.


Takimi përfundojë në ora 11 ¹⁰


1. Znj.Afërdita Lama




2.Z.Flamur Fetahaj 

3.Znj.Drita Buza 

4.Z.Zef Komoni 

5.Z.Mimoza Shala 



Për: Ardan Gini, Kryetar i Komunës së Gjakovës

Nga: "CACO" Sh.P.K., me adresë në Rr. Nena Terzi në p...

Lënda: Kërkesë për zgjidhje afari të Kontratës datës 04.10.2017 me nr. të protokollit 01-463/01-21147 për Dhomën në Shfrytëzim të objektit të Kinemasë së Qytetit

Data: 02 Nëntor 2018

Udhëzuar Kryetar,

Sic jeni në dijeni, në bazë të Vendimit të Kuvendit të Komunës së Gjakovës me nr. 011-2378 i datës 26.04.2016, është detyruar për dhënie në shfrytëzim afatshkurtë objekti i Kinemasë së Qytetit, që është evidentuar në parcelën me nr. P.70705029-0070-0 në zonën kadastrale Gjakovë dhe raportin të Komisionit Vlerësues, sipas njoftimit të datës 20.09.2017, është nënshkruar Kontrata e datës 04.10.2017 me nr. të protokollit 01-463/01-21147 për Dhomën në Shfrytëzim të pronës së paluajtshme në hall që është në pronësi të Komunës së Gjakovës.

Për ta kontraktuar kërkesën tonë, na lejoni që në titull të ndarë veçmas t'i paraqesim arsyetimet e kërkesës sonë, në mënyrë që objekti i kërkesës të jetë sa më i qartë dhe detyrues në raport me procedurat vijuese që do të bazohen sipas arsyeve të dhëna si mëposhtë:

QËLLIMI I KONTRATËS PËR DHËNIE NË SHFRYTËZIM TË PRONËS KOMUNALE

Kontrata e datës 04.10.2017 me nr. të protokollit 01-463/01-21147 për Dhomën në Shfrytëzim të objektit të Kinemasë së Qytetit (në vazhdim kontrata 01-463/01-21147), pas zhvillimit të procedurave të obligueshme në bazë të Ligjit 04/L-144 Për Dhënie në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës (në vazhdim Ligjit nr. 04/L-144) dhe Rregullores QRK 23/2013 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës (në vazhdim Rregullorja QRK 23/2013), është lidhur në mes të Komunës së Gjakovës në cilësi të dhënësit në shfrytëzim të pronës komunale në njërin anë dhe në anën tjetër në cilësi të shfrytëzuesit të pronës së hallë, Kompania D.P.H "CACO-BAJ", tani me status të reformatuar në "CACO" Sh.P.K., me pronar dhe agjent të autorizuar, z. Adnan Krasniqi.

REFERENCË: Certifikata e biznesit e faturuar nga ARBK-ja, datës 26.05.2018

Qëllimi i Kontratës 01-463/01-21147 – në bazë të klausulës kontraktuale nga Nenit 2 i Kontratës 01-463/01-21147, palët në kontratë kanë shprehur qëllimin e dhënies në shfrytëzim afatshkurtë për 10 vite pronën e Komunës së Gjakovës, për të funksionalizuar Kinematën e Qytetit, dhe për të krijuar një ambient të përshatshëm për qytetarët e Komunës së Gjakovës, përfshirë edhe personave nga vendet të tjera që vizitojnë këtë objekt, me qëllim të rritjes së numrit të vizitorëve, ofrimin të rekreacionit dhe zhvillimit dhe robrecapjen e aktiviteteve kulturo-recreative dhe multifunksionale për nevojat e qytetarëve të Komunës së Gjakovës.

Këtë qëllim kontraktual, palët janë dakorduar se do të realizohet përmes zbatimit të Planit të Biznesit dhe Planit Dinamik për funksionalizimin e Kinemasë së Qytetit sipas standardeve bashkëkohore.

digitalizimin e Kinemasë, mundësimin të shpërblimit të shfaqësve kulturorë artistikë dhe multifunksionale; si dhe zbatimin në standarde të kontraktimit, kalimit, menaxhimit dhe objektiv.

Ekzekutimi i Kontratës 01-463/01-21147

Që nga fillimi e Kontratës 01-463/01-21147, në vitin të shpërblimit dhe Investitor: "U.A.O.G. Sh.P.K" ka implementuar në veçanti Planin Dimenzit, sipas paragrafit dhe Nenit 9, paragrafi 1 dhe nënparagrafi 4.1.2 të Kontratës 01-463/01-21147. Madje, gjatë ekzekutimit të Kontratës 01-463/01-21147, në cilësi të investimit me të drejtë të shpërblimit të promës kontraktuale, shënime tani janë investuar 650,000.00 €. Mjetet të tilla janë investuar për funksionalizimin e sallave të tjera alternative që janë të shërbimit të destinimit të veçantë të objektit të Kinemasë. Investimi është kryesur që investimi i tillë të jetë me standarde të përmirës ndërdombëtarisht sa e përket infrastrukturës fizike të objekteve kulturore.

Për qëllime të arsyeshme të kërkesës për agjati të arsyt, të Kontratës 01-463/01-21147 për antishkallë prej 10 vitesh në 15 vite dhe të shpërblimit të promës të pajtueshme të hartuar, praqesim të përkrahësorë planit investiv i cili do të materializohet në Planin e Biznesit, si në vijim:

- Investimi për funksionalizimin të plotë të Kinemasë – Meqë nëse sipas Nenit 4 të Kontratës 01-463/01-21147, është paraparë si kusht i veçantë digitalizimin e Kinemasë, Investitori shpreh gatishmërinë që në afatin e ardhshëm prej 6 muajesh të ardhshëm, respektivisht deri në fundin e vitit 2019, të investojë edhe shumën prej 600,000.00 € të tjerë me qëllim të instalimit të teknologjive cilësore, që jo vetëm se do të përmbushin kushtet kontraktuale, por do të tejkalon standartet e planifikuara sipas Kontratës 01-463/01-21147. Investimi i tillë do të nënkuptojë jo vetëm digitalizimin e Kinemasë, por edhe krijimin e kushteve të veçanta me qëllim të përmbushjes së nevojave për funksionalizimin e plotë të sallave të tjera persepilose që do të përdoren për aktivitetet e ndryshme kulturore artistike dhe multifunksionale që për qytetërit e Gjakovës do të jetë një vend shumë atraktiv.
- Aftësitë investues për zgjerimin e kapaciteteve infrastrukturore – Mësimin i sallave të tjera alternative dhe multifunksionale i tyre do të nënkuptojë që objekti i Kinemasë, si objekt kompleks, do të kishte aftësitë që të ofrojë hapësirë dhe kushte të veçanta që përfshijnë por nuk kufizohet në filmografi, teatër, sallë koncertuale, aktivitetet muzikore, galeri artistike dhe mundësi për organizimin e aktivitetesh dhe ngjarjeve të ndryshme kulturore dhe shoqërore në përgjithësi.
- Impakti ekonomik i investimit – Me investimin e ndalshëm prej 600,000.00 € të tjerë sipas Planit të Biznesit, jo vetëm se do të kontribuohet në mbështetjen e Kulturës të Komunitetit të Gjakovës, por në të njëjtën kohë investimi i tillë do të kishitë ndikim të drejtpërdrejt në ekonominë vendëse. Aktualisht, investimi i tillë të punësuar gjatësej 45 punësorë të cilët përbenin shumën më të madhe që janë të angazhuar në aktivitetet e investimit sipas desaturimit të shpërblimit të promës kontraktuale me destinim të përcaktuar. Kështu që në kuadër të investimit shitesë për 6 muajt të ardhshëm do të punësoheshin 65 të punësuar në total.

Sipas përlogritjes vjetore, vetëm në kupim të gjenerimit të të ardhurave nga të punësuarit, shuma prej 350,000.00 € do të ishte impakti pozitiv financiar nga të ardhurat e të punësuarëve për periudhë një vjeçare. Në këtë shumë nuk kemi llogaritur të hyrat që do të gjeneroheshin nga obligimet lidhur me tarrim në të ardhurat personale. Pra, llogaruar në një detyrëveçor të ardhshëm, vetëm nga pozimi i punësuarit, investimi i tillë do të gjenerojë së paku vlerë monetare prej 3,500,000.00 €.

Te ardhurat nga investimi i tilla do te përcaktohen edhe te kalburen te neta nga shprehjet e përgjithshme kulturore dhe artistike, i cilat do te lëvizin në një nivelin e ri.

Kontributi në jetën kulturore të Komunës së Gjakovës – Zbatimi i investimit shpesh do te efektiviteti i Planit Dinamik dhe Planit të Biznesit, do te rrisë në nivelin e ri edhe edhe cilësinë e jetës kulturore të Komunës së Gjakovës. Sidoqoftë investimi mundet paraqitet në forma të ndryshme, ndikimi i investimit të tilla me një dësi të veçantë është shprehjet në turizmin e ri me investimet për zhvillimin e jetës kulturore. Andaj kështu i kushtojmë të vëmendje për investimet shpesh te investimit do të rrisë cilësinë e kapaciteteve infrastrukturore në fushën e kulturës dhe arti, që që shpesh nga investimi i përgjithshëm i Komunës së Gjakovës do të ishte i rëndësishëm sidomos në raport me gjendjen në të cilën gjendej Komunja e Qyteti para ditëve të tilla të shprehjes.

Pjesëmarrja e investimit në planin urbanistik dhe estetiken urbanistike – Para ditëve të Komunitetit 01-463/01-21147, objekti i Kinemasë ka qenë simbol i shprehjes të qytetit të Gjakovës, sa i përket mirëmbajtjes dhe ambientit përreth. Një gjendje e tillë jo vetëm se ka i përket një objekti të destinuar për aktivitete kulturore, por përfaqëson një pamje e tillë kishte efekt negativ edhe për qytetarët e Gjakovës si dhe për vizitorët nga vendet e tjera. Pasqyra më konkrete e mirëmbajtjes të shprehjes publike sigurohet se do të ishte objekti kulturor, ka detyrë vëmendje të shprehjes vetëdijë qytetare sa i përket jetës kulturore dhe asaj publike.

Nga fillimi i efektiviteti të Planit Dinamik Investues, Investitori, Sh.P.K. "CACCOO" ka ardhur që të ndryshojë pamjen e jashtme dhe të brendshme të Kinemasë. Tani pamja, jo vetëm e objektit dhe fasadës së jashtme, por edhe e ambientit përreth, e ka bërë një atmosferë të re të ndryshme. Hapësira e gjelbra, e cila krijon përshpënjën e pastër me rastin e vizitës së objektit, është ndër elementet thelbësore që të përshpënjë tek vizitorët.

Entiteti bashkëkohor, me stilistikë të veçantë artistike, ambient hospitalizues dhe i përshpënjës që të ofrojë shprehjet e nevojshme për vizitorët në përgjithësi, është mirëmbajtja kryesore që e argumenton investimin e drejtë të destinuar të investimit. Dhe megjithatë ky investim është bërë deri më tani, pjesa e investimit shpesh do të kompletonte këtë objekt me shprehjet e veçanta multidimensionale të infrastrukturës publike.

Objekti i cili do të kompletohet me zbatimin e investimit shpesh, do të ishte kompletuar me pjesëmarrjen e tij në pamjen urbanistike. Aspekti estetik, është i rëndësishëm në jetën publike. Aq me shprehjet kur këtu të bëjmë me një objekt kulturor, i cili nuk ka veçanë karakter të ofronit të shprehjes të caktuar. Por i njëjti do të ishte formëzues për vizitorët, me theks të veçantë për grupmishërit e re, si potencial i ardhshëm kulturor dhe artistik.

Prandaj, Investimi të tilla duhet t'i jepet rëndësi duke i liguar kushte të vëmendje atyqer investimit, që kryesorit përshpënjë aspektin kohor të shprehjes objektit, të cilin do ta aktivizojë me kapacitetin e plotë destinues.

Investimi shpesh i shprehjes të pronës komunale sipas Komunitetit 01-463/01-21147, do te jetë i pamundur në qoftë se shprehjes i kësaj prone do të kalibohet në 10 vite, siç ishte kontraktuar me parë. Rritja e ambicies së investimit do të duhet të shprehjet si përparësi në raport me nevojat e Komunës së Gjakovës përkalëzi me jetën kulturore dhe artistike dhe mirëmbajtjen e përgjithshme të qytetarëve. Prandaj, në bazë të arsyeve të lartëçkura, duke u mbështetur në dispozitat e Ligjit nr. 04/L-144, Neni 5,

paragrafi i Rregullorit Nën 10, paragrafi 3, në lidhje me Nenin 5, paragrafi 1 të Kushtetutës QKB 23/2013, sipas autorizimeve të tilla, në cilën të Kryetari i Komititës kërkohet nga ju që sipas propozimit Tuaj (i drejtuar Komisionit Vlerësues bazuar në arsyet e mësipërme dhe në objektin e Planit të Biznesit dhe Planit Duanit, për investimet shpirtërore të planifikuara të propozuara në kontratën 01-463/01-21147), dala zgjedhje afatshkurtes nga 10 vite deri në 15 vite shpirtërore të objektit të Komitës së Qytetit që është lehtë e Komitës 01-463/01-21147. Ndaloje të menjshme shpirtërore nuk është parashikuar që vlerësohet Komisionit Vlerësues përkatës me prirje komunale që janë diskutuar për detyrë të shpirtërore afatshkurtes të jetë miratuar nga Kuvendi i Komunës, në propozim që përfaqëson tërësisht, për të cilën ju si Kryetar i Komunës nuk duhet të ktheheni në mënyrë të veçantë, vlerësohet Komisionit Vlerësues për zgjedhje afatshkurtes Komitës 01-463/01-21147 të drejtuar për miratim Kuvendi të Komunës së Gjakovës.

Në besim të se në mënyrë të plotë dhe të barabart në faktet legjore dhe juridike, kemi përfunduar kryerjen e ngritjes së kontratës 01-463/01-21147 të anulohet me qëllim të zgjedhjes së afatshkurtes të objektit të Komitës, nga 10 vite në 15 vite, në lundrin e afatshkurtes, që është parashikuar me legjislacionin përkatës në fuqi. Në lundrin e hollësimit për zgjedhje të afatshkurtes të objektit të Komitës që përbëhet pranë komunale, kërkohet që me qëllim të përbashkët të jetë investimet në Komunën e Gjakovës, qiraja aktuale të ulët për 50% të shumës, dhe i poqë nuk do të dëmtojë interesin e Komunës së Gjakovës.

Shpresojmë se kërkesa jonë do të shqirohet në kohë sa më të shpejtë dhe për qëllime të përshirura në të do të fillojë zbatimin i procedurave përkatëse administrative.

Ju falënderojmë pa prapësi në mirëkuptimin Tuaj.

Vërejtje: Kësaj shkresë do t'i bashkohim në kopje të gjitha referencat e cituara në tekstin e mësipërm, si dhe Planin e Biznesit së bashku me Planin Duanit të vijat.

Me respekt,

Adnan Krasniqi
Përzgjedhur i autorizuar
"CACOO" SH.PK.

Gjakovë, 2 Nëntor 2018.



Për: z. Rozafa Ukimeraj, Sekretare e Përgjithshme e Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal

Nga: “CaCoo” Sh.P.K., me adresë në Rr. Nënat Terezë p.n., Gajkovë, përfaqësuar me autorizim nga Avokat Arianit Koci;

Lënda: Informatë lidhur me kërkesën e datës 01 Nëntor 2018 drejtuar Kryetarit të Komunës së Gjakovës për zgjatje të afatit të Kontratës datës 04.10.2017 me nr. të protokollit 01-463/01-21147 për Dhënie në Shfrytëzim të objektit të Kinemasë së Qytetit

Data: 21 Shkurt 2019

E nderuara Znj. Ukimeraj,

Ashtu siç mund të jeni në dijeni, në bazë të Vendimit të Kuvendit të Komunës së Gjakovës me nr. 011-2378 i datës 26.04.2016, është destinuar për dhënie në shfrytëzim afatshkurtë objekti i Kinemasë së Qytetit, që është evidentuar në parcelën me nr. P-70705029-0070-0 në zonën kadastrale Gjakovë dhe raportit të Komisionit Vlerësues, sipas njoftimit të datës 20.09.2017, është nënshkruar Kontrata e datës 04.10.2017 me nr. të protokollit 01-463/01-21147 për Dhënie në Shfrytëzim të pronës së paluatjshme në fjalë që është në pronësi të Komunës së Gjakovës.

Me datën 01 Nëntor 2018, ne kemi dorëzuar një kërkesë Kryetarit të Komunës së Gjakovës për zgjatje të afatit të Kontratës datës 04.10.2017 me nr. të protokollit 01-463/01-21147 për Dhënie në Shfrytëzim të objektit të Kinemasë së Qytetit.

Kuvendi Komunal i Gjakovës me datën 04 Dhjetor 2018, ka marrë Vendimin 01.nr.463/02-33027/2018 për zgjatjen e afatit të shfrytëzimit të pronës komunale. Ky vendim i është dërguar, në mes të tjerave Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, e cila bazuar në Kompetencat që burojnë nga Ligji dhe ne jemi në dijeni se Ministria është duke e trajtuar të njëjtin.

Andaj, për ta mbështetur vendimin e Kuvendit Komunal si dhe për të dhënë arsyet e kërkesës tonë për zgjatjen e afatit të kontratës na lejon që në tituj të ndarë veçmas t'i paraqesim arsyetimet e kërkesës sonë, në mënyrë që objekti i kërkesës të jetë sa më i qartë dhe decidiv në raport me procedurat vijuese që do të bazohen sipas arsyeve të dhëna si mëposhtë:

QËLLIMI I KONTRATËS PËR DHËNIE NË SHFRYTËZIM TË PRONËS KOMUNALE

Kontrata e datës 04.10.2017 me nr. të protokollit 01-463/01-21147 për Dhënie në Shfrytëzim të objektit të Kinemasë së Qytetit (në vazhdim Kontrata 01-463/01-21147), pas zhvillimit të procedurave të obligueshme në bazë të Ligjit 04/L-144 Për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluatjshme të Komunës (në vazhdim Ligjit nr. 04/L-144) dhe Rregullores QRK 23/2013 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluatjshme të Komunës (në vazhdim Rregullorja QRK 23/2013), është lidhur në mes të Komunës së Gjakovës në cilësi të dhënësit në shfrytëzim të pronës komunale në njërën anë dhe në anën tjetër në cilësi të shfrytëzuesit të pronës së tillë, Kompania D.P.H. “CACOO-Bar”, tani me status të transformuar në “CACOO” Sh.P.K., me pronar dhe agjent të autorizuar, z. Adnan Krasniqi.

REFERENCË: Certifikata e biznesit e lëshuar nga ARBK-ja, datës 26.03.2018

Qëllimi i Kontratës 01-463/01-21147 – në bazë të klauzolës kontratuale nga Neni 2 i Kontratës 01-463/01-21147, palët në kontratë kanë shprehur qëllimin e dhënies në shfrytëzim afatshkurtë për 10 vite pronën e Komunës së Gjakovës, për të funksionalizuar Kinemanë e Qytetit, dhe për të kirjuar një ambient të përshtatshëm për qytetarët e Komunës së Gjakovës, përfshirë edhe personave nga vendet të tjera që e vizitojnë këtë objekt, me qëllim të rritjes së numrit të vizitorëve, ofrimit të rekreacionit dhe zhvillimit dhe mbarëvajtjen e aktiviteteve kulturoro-artistike dhe multifunkionale për nevojat e qytetarëve të Komunës së Gjakovës.

Këtë qëllim kontraktual, palët janë dakorduar se do të realizohet përmes zbatimit të Planit të Biznesit dhe Planit Dinamik për funksionalizimin e Kinemasë së Qytetit sipas standardeve bashkëkohore; digjitalizimin e Kinemasë; mundësit të zhvillimit të aktiviteteve kulturore dhe artistike; si dhe zbatimit të standardeve të kontraktuara lidhur me mriëmbajtjen e objektit.

Ekzekutimi i Kontratës 01-463/01-21147

Që nga lidhja e Kontratës 01-463/01-21147, në cilësi të shfrytëzuesit dhe Investitorit, Sh.P.K. “CACOO” ka implementuar në veçanti Planin Dinamik, siç është paraparë me Nenin 4, paragrafin 4.1 me nënparagrafin 4.1.2 të Kontratës 01-463/01-21147. Madje, gjatë ekzekutimit të Kontratës 01-463/01-21147, në cilësi të investitorit me të drejtë të shfrytëzimit të pronës komunale, deri më tani janë investuar 650,000.00 €. Mjetet të tilla janë investuar për funksionalizimin e sallave të tjera alternative që janë në shërbim të destinimit të veçantë të objektit të Kinemasë. Investitori është kujdesur që investimi i tillë të jetë me standarte të pranuar ndërkombëtarisht sa i përket infrastrukturës fizike të objekteve kulturore.

Për qëllime të arsyeshmërisë së kërkesës për zgjatje të afatit të Kontratës 01-463/01-21147 për afatshkurtë prej 10 viteve në 15 vite dhënie në shfrytëzim të pronës të paluajtshe të lartëcekur, paraqesim në pika thelbësore planin investiv i cili do të materializohet në Planin e Biznesit, si në vijim:

- **Investimi për funksionalizim të plotë të Kinemasë** – Meqenëse sipas Nenit 4 të Kontratës 01-463/01-21147, është paraparë si kusht i veçantë digjitalizimi i Kinemasë, Investitori shprehë gatishmërinë që në afatin e ardhshëm prej 6 muajve të ardhshëm, respektivisht deri muajin prill të vitit 2019, të investojë edhe shumë prej 700,000.00 € të tjera me qëllim të instalimit të teknologjisë cilësore, që jo vetëm se do të përmbushte kushtet kontraktuale, por do t'i tejkalonte standardet e planifikuara sipas Kontratës 01-463/01-21147. Investimi i tillë do të nënkuptonte jo vetëm digjitalizimin e Kinemasë, por edhe krijimin e kushteve të veçanta me qëllim të përmbushjes së nevojave për funksionalizimin e plotë të sallave të tjera përcjellëse që do të përdreshin për aktivitetet e ndryshme kulturore dhe artistike qw pwr qytetarwt e Gjakovws do tw jetw njw vendw shumw atraktivw.
- **Afiniteti investues për zgjerimin e kapaciteteve infrastrukturore** - Aktivizimi i sallave të tjera alternative dhe multifunksionaliteti i tyre do të nënkuptonte që objekti i Kinemasë, si objekt kompleks, do të kishte afinitet që të ofrojë hapësirë dhe kushte të veçanta që përfshinë por nuk kufizohet në filmografi, teatër, sallë koncertale, aktivitete muzikore, galeri artistike dhe mundësi për organizimin e aktiviteteve dhe ngjarjeve të ndryshme kulturore dhe shoqërore në përgjithësi.
- **Impakti ekonomik i investimit** – Me investimin e ardhshëm prej 700,000.00 të tjera sipas Planit të Biznesit, jo vetëm se do të kontribuohet në mirëqënien kulturore të Komunës së Gjakovës, por në të njëjtën kohë investimi i tillë do të kishte ndikim të drejtpërdrejt në ekonominë vendëse. Aktualisht, investitori i ka të punësuar gjithsej 45 punëtorë të cilët përbëjnë

burimin njerëzor që janë të angazhuar në aktivitetin e investitorit sipas destinimit të shfrytëzimit të pronës komunale me destinim të përcaktuar. Kështu që në kuadër të investimit shtesë për 6 muajt të ardhshëm do të punësoheshin 65 të punësuar në total.

Sipas përlogaritjes vjetore, vetëm në kuptim të gjenerimit të të ardhurave nga të punësuarit, shuma prej 350,000.00 € do të ishte impakti pozitiv financiar nga të ardhurat e të punësuarëve për periudhë një vjeçare. Në këtë shumë nuk kemi llogaritur të hyrat që do të gjeneroheshin nga obligimet lidhur me tatimin në të ardhurat personale. Pra, kalkuluar në një dhjetëvjeçar të ardhshëm, vetëm nga prizmi i punësimit, investimi i tillë do të gjenerojë së paku vlerë monetare prej 3,500,000.00 €.

Të ardhurat nga investimi i tillë do të gjeneronte edhe të ardhurat të tjera nga aktiviteti i përgjithshëm kulturor dhe artistik, i cili do të kthehej në një atraksion vendor.

- **Kontributi në jetën kulturore të Komunitetit të Gjakovës** – Zbatimi i investimit shtesë dhe ekzekutimi i Planit Dinamik dhe Planit të Biznesit, do të rrisë në masë të madhe edhe cilësinë e jetës kulturore të Komunitetit të Gjakovës. Sado që investimi financiar paraqitet në numëra konkret, ndikimi i investimit të tillë me një cilësi të veçantë është indikator në krijimin e një infrastrukture për zhvillimin e jetës kulturore. Andaj krijimi i kushteve të volitshme për investimin shtesë të investitorit do të rrisë cilësinë e kapaciteteve infrastrukturore në fushën e kulturës dhe artit, gjë që shihet nga interesi i përgjithshëm i Komunitetit të Gjakovës, do të ishte i mirëseardhur, sidomos në raport me gjendjen në të cilën gjendej Kinemaja e Qytetit para dhënies së tillë në shfrytëzim.
- **Pjesëmarrja e investimit në planin urbanistik dhe estetikën urbanistike** – Para dhënies së Kontratës 01-463/01-21147, objekti i Kinemasë ka qenë simbol i shëmtisë të qytetit të Gjakovës sa i përket mirëmbajtjes dhe ambientit përreth. Një gjendje e tillë jo vetëm se nuk i përkiste një objekti të destinuar për aktivitete kulturore, por përkundrazi, një pamje e tillë kishte efekt negativ edhe për qytetarët e Gjakovës si dhe për vizitorët nga vendet të tjera. Pasqyra më konkrete e menaxhimit të sferës publike sigurojnë se do të ishte objekti kulturor, ku do të vinte në shprehje vetëdija qytetare sa i përket jetës kulturore dhe asaj publike.

Nga fillimi i ekzekutimit të Planit Dinamik investues, Investitori, Sh.P.K. “CACOO” ka arritur që të ndryshojë pamjen e jashtme dhe të brendshme të Kinemasë. Tani pamja, jo vetëm e objektit dhe fasadës së jashtme, por edhe e ambientit përreth, e ka bërë një atmosferë tërësisht ndryshe. Hapësira e gjelbëruar, e cila krijon përshtypjen e parë me rastin e vizitës së objektit, është ndër elementet thelbësore që lë përshtypje tek vizitorët.

Enterieri bashkëkohor, me stilistikë të veçantë artistike, ambientet hospitalizues dhe i përshtatshëm që të ofrojë shërbimet të nevojshme për vizitorët në përgjithësi, është nuansa kryesore që e argumenton investimin e drejtë të deritanishëm të investitorit. Dhe meqenëse ky investim është bërë deri më tani, pjesa e investimit shtesë do të kompletonte këtë objekt me vlera të veçanta multidimensionale të infrastrukturës publike.

Objekti i cili do të kompletohet me zbatimin e investimit shtesë, do të ishte komplementar me pjesëmarrjen e tij në pamjen urbanistike. Aspekti estetik është i rëndësishëm në jetën publike. Aq më shumë kur kemi të bëjmë me një objekt kulturor, i cili nuk ka vetëm karakter të ofrimit të shërbimeve të caktuara. Por i njëjti do të ishte frymëzues për vizitorët, me theks të veçantë për grupmoshën e re, si potencial i ardhshëm kulturor dhe artistik.

Prandaj, Investimit të tillë duhet t'i jepet mundësia duke i krijuar kushte të volitshme afariste investitorit, që kryesisht përfshinë aspektin kohor të shfrytëzimit objektit, të cilin do ta aktivizojë me kapacitetin e plotë destinues.

Investimi shtesë i shfrytëzuesit të pronës komunale sipas Kontratës 01-463/01-21147, do të jetë i pamundur në qoftë se shfrytëzimi i kësaj prone do të kufizohet në 10 vite, siç ishte kontraktuar më parë. Rritja e ambicies së investitorit do të duhej të shiqohej si përparësi në raport me nevojat e Komunës së Gjakovës përkitazi me jetën kulturore dhe artistike dhe mirëqenien e përgjithshme të qytetarëve. Prandaj, në bazë të arsyeve të lartëcekura, dhe në mbështetje të Planit të Biznesit dhe Planit Dinamik për investimet shtesë të planifikuara, ne kemi kërkuar që të zgjatet afatshmërinë nga 10 vite deri në 15 vite shfrytëzim të objektit të Kinemasë së Qytetit që është lëndë e Kontratës 01-463/01-21147..

Ne besojmë se në mënyrë të plotë dhe të bazuar në fakte ligjore dhe juridike, kemi ofruar arsye të mjaftueshme që Kontrata 01-463/01-21147 të ankesohet me qëllim të zgjatjes së afatit të shfrytëzimit të objektit të Kontratës, nga 10 vite në 15 vite, në kuadrin e afatshmërisë, siç është paraparë me legjislacionin përkatës në fuqi.

Ju faleminderojmë paraprakisht në mirëkuptimin Tuaj.

Me respekt,

Prishtinë, 21 Shkurt 2019

Arianit Koci
Përfaqësues i autorizuar
"CACOO" Sh.P.K.

Avokat i Autorizuar

Tel: 044 518 638
koci@koci-vokshi.com
Prishtine